



FOKUSI
Albania - Kosova

Seria C
Kisha e Krishtit
Manuali



FOKUSI – Seri C - Manuali

Kisha e Krishtit

Hyrje

Mirësevini në takimet e "Fokusit". Në këtë seri do të gjeni 5 tema. "FOKUSI" përdor katër shtylla për të strukturuar takimet. Çdo takim përbëhet nga disa elemente fikse, të cilat janë si më poshtë:



a. Studimi i Biblës

Së pari, ne duam të njohim Fjalën e Perëndisë duke studiuar së bashku një pjesë të Biblës. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me njohurinë dhe kuptimin më të mirë të asaj që shkruhet dhe çfarë do të thotë, por edhe për mënyrën se si mund ta zbatojmë atë në jetën tonë dhe se si përshtatet kjo pjesë e Biblës me përvojat tona.



b. Lutje

Lutja është themeli i gjithë serive të Fokusit. Duke u varur tek Perëndia, ne duam të arrijmë atë që Zoti mund të bëjë në mesin tonë dhe se si Ai mund të punojë përmes nesh. Prandaj, ne duam të lutemi për bekimin e tij, ta falënderojmë dhe ta adhurojmë. Në të njëjtën kohë ne duam të ndërmjetësojmë për njerëzit dhe situatat që po kalojnë.





c. Në lëvizje

Është e rëndësishme të zbatojmë gjërat që do të mësojmë dhe zbulojmë në këto takime. Në këtë pjesë, propozohen hapa të vegjël që mund të bëjmë si një ushtrim në situatën tonë. Ndonjëherë personalisht, ndonjëherë si grup ose si kishë, ne do të inkurajojmë njëri-tjetrin që me të vërtetë ti zhvillojmë ato aktivitete duke bërë plane konkrete dhe më vonë duke pyetur njëri-tjetrin se si i kemi praktikuar ato plane.



d. Ndarja e tregimeve

Në seksionin "Ndarja e tregimeve", ju jeni të ftuar të shprehni mendimet tuaja për Zotin dhe besimin dhe t'i ndani me të tjerët. Për më tepër, njerëz nga vende të ndryshme do të flasnin për temat në video të shkurtra. Ata përpiqen të ecin me Perëndinë në rrethana të ndryshme, por të gjithë kanë pyetje dhe situata të ngjashme si ju.

“Fokusi” është një proces shpirtëror

Ky material për grupet është pjesë e serisë “Fokusi”, e cila ka për qëllim të fillojë një proces reflektimi për të gjithë kishën se si mund të jemi një kishë misionare me një përqendrim të përtërirë në Jezus Krishtin. Kjo seri e “Fokusit” është si një rrugë që ecim së bashku. Gjithsej janë gjashtë seri.

“Fokusi” është një proces mësimi i cili ka për qëllim të inkurajojë dy lëvizje:



- a. Një lëvizje në drejtim **të brendësisë**, drejt zemrës së kishës dhe drejt zemrës sonë personale. Ne do të flasim në thellësi se kush është Zoti në jetën tonë. Ne gjithashtu do të flasim për kuptimin e njohjes së Jezusit dhe të jetuarit me të. Si mund të jemi dëshmitarë besnikë në ditën e sotme? Kjo është një pyetje në radhë të parë për besimin tonë personal. Si mund ta lidhim besimin tonë në jetën tonë të përditshme: me punën tonë, me familjen tonë, me lagjen tonë, me miqtë tanë. Praktikisht: si mund ta lidhim besimin tonë në vendin dhe rolin që Zoti na ka caktuar.



- b. Lëvizja e dytë ka të bëjë me një lëvizje të përtërirë drejt **të jashtmes**. Ne i hapim sytë, zemrat tona dhe jetën tonë për njerëzit përreth nesh. Sidomos për njerëzit që ende nuk e njohin Jezusin. Ne do të kërkojmë këtë lëvizje të jashtme që nga fillimi i kësaj serie “Fokusi”. Në secilin mësim do të kërkojmë sesi mund të jemi të përfshirë në mënyrë praktike dhe aktive, kështu që nuk do të jetë thjesht një reflektim dhe diskutim i pafund.



Sfondi

Qëllimi i serisë “Fokusi” është të mbështesë kishat në thirrjen e tyre misionare. Materiale të ndryshme janë zhvilluar duke dëgjuar me kujdes pyetjet e shumë të krishterëve dhe kishave.



Seria “Fokusi” nuk është vetëm një metodë, një strategji apo një program. Është para së gjithash një proces shpirtëror, një proces reflektimi, thellimi dhe ndryshimi.

Ne ndjekim **disa vlera kryesore** që shpjegojnë se çfarë është e rëndësishme në serinë “Fokusi”:

A. Kërkimi dhe përlësia

Procesi fillon duke parë me ndershmëri situatën në veten tonë. Shpesh ne jemi të pasigurt në lidhje me sfidën e madhe të kishës për të qenë një kishë misionare në një shoqëri laike. Sekularizmi dhe mosinteresi për besimin nuk është vetëm diçka jashtë nesh por ndikon edhe në jetën tonë dhe zemrat tona si të krishterë. Ka shumë besimtarë që janë shumë të rregullt me pjesëmarrjen në mbledhjet e kishave, por në zemrat e tyre nuk janë shumë seriozë me besimin e tyre. Kjo mund të na bëjë të ndihemi të pasigurt dhe të përlur. Kur flasim në serinë “Fokusi” për ndryshimin, ne flasim në radhë të parë për ndryshimin në jetën tonë. Është e nevojshme që së pari të përllemi para Zotit, që të jemi të sigurtë me veten tonë, pasiguritë tona dhe pamundësitë tona.



Ne mund t'i kapërcejmë këto probleme vetëm duke kuptuar se sa jemi të varur tek hiri i Zotit. *“Në qoftë se populli im, i cili thirret me emrin tim, përulet, lutet, kërkon fytyrën time dhe kthehet prapa nga rrugët e këqija, unë do ta dëgjoj nga qielli, do t'i fal mëkatën e tij dhe do ta shëroj vendin e tij”.* (2 Kronikave 7:14)

B. Dëshira dhe pritja

Ne nuk duam të përqendrohemi në situatën aktuale ose ta pranojmë atë. Ne besojmë se dëshira për ndryshim dhe përtëritje vendoset në zemrat tona nga Fryma e Zotit. Ne besojmë në thirrjen e lartë që Zoti ka për kishën e tij. Kur dëshira përziehet me besimin, lind një qëndrim i pritjes. Ne nuk e presim atë nga angazhimi ynë, nga njohuritë ose veprimtaritë tona, por ne e presim atë vetëm nga Ai që na dërgon me fjalët: *“Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë ... dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës”.* (Mateu 28: 19,20). Fillon me të jetuarit në praninë e tij dhe besimi se asgjë nuk është e pamundur për Të.

C. Përbushja dhe rinovimi

Në Dhiatën e Re misioni nuk është vetëm një përkushtim, por edhe një premtim: *“Ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi në Jeruzalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut”* (Veprat 1: 8) Ne besojmë se dëshmia jonë do të sjellë fryte dhe se ndryshimi i vërtetë është i mundur vetëm përmes fuqisë së Frymës së Shenjtë, i cili na mbush dhe rinovon jetën tonë nga brenda. Në serinë “Fokusi” ne duam të kemi shumë kohe për lutje dhe duam të përqendrohemi në atë që vetë Zoti dëshiron të bëjë në ne dhe përmes nesh përmes Frymës së Tij.

D. Thellimi dhe zgjerimi

Kur ne mendojmë për ungjillëzimin dhe një kishë misionare mendohen shpejt për modelet, metodat dhe



aktivitetet e reja. Por ne besojmë se së pari duhet thellimi shpirtëror. Bëhet fjalë për zemrën tonë, besimin tonë, jetën tonë. Kush është Jezus Krishti për ne dhe si e jetojmë jetën tonë me Të? A i bëjmë gjërat tona gjatë javës, apo vërtet përpiqemi të imitojmë Krishtin në jetën tonë?

Përveç këtij thellimi shpirtëror, zgjerimi është gjithashtu i nevojshëm, në mënyrë që diskutimi për dishepullizimin dhe mënyrën e jetesës misionare të mos kufizohet në një grup të vogël anëtarësh të kishës, por që e gjithë kisha të përfshihet.

Pika të vëmendjes për një bisedë të mirë

Të gjithë marrin pjesë dhe mund të flasin

Një bisedë e mirë fillon me të dëgjuar. Mundohuni së bashku të siguroheni që të gjithë në grup mund të flasin dhe që të gjithë të dëgjoen.

Roli i drejtuesit të bisedës

Drejtuesi i bisedës nuk është eksperti i cili duhet t'i përgjigjet të gjitha pyetjeve ose të përcaktojë nëse përgjigjet janë të drejta ose të gabuara. Ai / ajo është atje për të bërë bisedën dhe, nëse është e nevojshme, për ta thelluar atë. Ai / ajo gjithashtu monitoron kohën dhe ndihmon grupin të vazhdojë diskutimin.

Pyetje personale

Shumë nga pyetjet në këtë material nuk janë pyetje diturie, të cilave mund t'i jepet vetëm një përgjigje e saktë. Shumica e pyetjeve janë krijuar për të filluar një bisedë se çfarë do të thotë teksti i Biblës në situatën tonë personale. Pyetjet na ndihmojnë të zbatojmë Biblën në jetën tonë. Ne mund të ndihmojmë dhe inkurajojmë njëri-tjetrin në këtë.



Dëgjimi i njëri-tjetrit dhe Zotit

Përveçse duam të dëgjojmë njëri-tjetrin, ne natyrisht duam të dëgjojmë atë që Zoti dëshiron të na tregojë përmes Biblës dhe përmes Frymës të Tij. Për këtë arsye, është bërë shumë vend për lutje. Le të marrim kohë të mjaftueshme për t'u lutur gjatë mbledhjes.

Në lëvizje

Pjesa "Në lëvizje" është një pjesë e rëndësishme sepse është si një urë lidhëse midis asaj që diskutojmë në Bibël dhe praktikës së jetës sonë të përditshme. Jemi të inkurajuar të marrim hapa konkret. Ne mund të ndihmojmë njëri-tjetrin duke bërë plane sa më konkrete të jetë e mundur. Mos pyesni vetëm njëri-tjetrin se çfarë dëshironi të bëni, por edhe konkretisht: Ku, me kë, kur dhe si?

Ndarja e tregimeve

Seksioni "Ndarja e tregimeve" është krijuar për të zbuluar se si Zoti i angazhon njerëzit dhe punon përmes tyre. Ne e bëjmë këtë duke dëgjuar tregimet e të krishterëve të tjerë, të cilët mund të jetojnë afër ose larg. Por edhe duke i thënë njëri-tjetrit se çfarë përvojash kemi me kryerjen e ushtrimeve nga seksioni "Në lëvizje". Është e rëndësishme që të dëgjojmë tregimin e personit tjetër, pa dhënë menjëherë komente ose këshilla të padëshiruara.

Kthehu te thelbi

Qëllimi i këtij materiali diskutimi është që të bashkohemi në një fokus të ri. Një fokus të ri në Jezus Krishtin. Mundohuni të ktheheni përsëri në këtë gjë thelbësore, kur largoheni gjatë bisedës, ose kur futeni në diskutime rreth çështjeve dytësore.



Konfidencialiteti

Jini të kujdesshëm me informacionin që dëgjoni nga njëri-tjetri. Sa më personale të bëhet biseda, aq më e vlefshme është. Por nëse i thoni gjërat personale, kjo ju bën gjithashtu të prekshëm. Prandaj, është e nevojshme një atmosferë e sigurt në të cilën të gjithë vlerësohen dhe besimi nuk tradhtohet.



Atmosferë e mirë

Krijoni një atmosferë të mirë dhe të rehatshme. Bisedat duhet të zhvillohen në kishën e Krishtit. Ne e dimë se jo të gjithë njerëzit janë njësoj por Perëndia mund të punojë në njerëz të ndryshëm në mënyra shumë të ndryshme. Mahnituni me atë që ju jep Zoti. Ne e kuptojmë se në bisedat tona dhe detyrat konkrete që bëjmë, ne jemi plotësisht të varur nga Fryma e Zotit. Ai madje punon përmes pafuqisë sonë.

Lutje

Lutja është një pjesë e rëndësishme e “Fokusit”. Ne besojmë se një seri e “Fokusit” ka vetëm kuptim nëse ajo zhvillohet me lutje. A doni të luteni për procesin e “Fokusit” në kishën tuaj? Më poshtë janë disa sygjerime lutjeje që mund të përdorni në grup ose në shtëpi.

Përrulje

Në procesin e “Fokusit” është e rëndësishme të kërkonti falje. Ne duhet të jemi të sigurtë me Perëndinë dhe t'i tregojmë atij për vaktësinë tonë, ndrojtjen tonë, paaftësinë tonë dhe fajin tonë. Gjithë këto gjera janë në zemrat tona. Përmendeni këtë në lutje dhe kërkojini Zotit falje.



Lutje

- Lutuni për programin “Fokusi” në kishë. Kërkojini Zotit të bekojë procesin. Mendoni për atë që dëshironi për procesin e “Fokusit”. Çfarë doni të ndodhë me veten tuaj? Po me kishën? Shprehi këto mendime tek Zoti.



- Lutuni për udhëheqësin e kishës dhe udhëheqësit e tjerë dhe rolin e tyre në proces.
- Lutuni për pjesëmarrësit në serinë “Fokusi”.
- Lutuni që Zoti të bekojë bisedat dhe t'i ndihmojë pjesëmarrësit të zbatojnë atë që mësojnë.
- Lutuni për anëtarët e Kishës dhe kërkoni nga Zoti që të ketë një takim të ri me Jezusin.
- Lutuni për njerëzit që takoni në jetën e përditshme që nuk e njohin Zotin akoma. Lutuni që ata të njihen me Jezus Krishtin.

Falënderime

- Falënderoni Zotin për Atë që është dhe për çfarë Ai ka bërë për ne.
- Falënderoni Zotin për këtë seri të “Fokusit” në kishën tuaj.
- Falënderoni Zotin për kishën në të cilën jeni anëtarë.



Tema e parë:

Të lidhur në unitet



1. **Mirëpresim** njerëzit dhe fillojmë me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.
2. **Fillojmë me listën në faqen 2.** Për pjesët e ndryshme mund të përmendni:
 - a. **Adhurimin.** Është shumë i rëndësishëm. Shpesh njerëzit kujtojnë më shumë nga këngët sesa nga predikimi. Shpesh adhurimi prek ndjenjat e tua. Edhe nëse duam t'u mësojmë fëmijëve diçka të re nga Bibla ose besimi, shpesh e bëjmë këtë në formën e një kënge. Martin Luteri tha: Adhurimi ka të njëjtë fuqi sesi unë lutem 2 herë”.
 - b. **Lutjet.** Është shumë e rëndësishme që të lutemi. Mund të lutemi për njëri-tjetrin. Nëse unë jam i dobët, ju mund të luteni për mua, dhe anasjelltas. Lutja nuk është vetëm t'i kërkosh Zotit një nder, por edhe të rrëfesh mëkatet, të kërkosh falje, të lëvdosh Perëndinë, të nderosh dhe të lutesh për njëri-tjetrin dhe për botën (ndërmjetësimin).
 - c. **Dëshmitë,** janë shumë të rëndësishme. Disa mendojnë se Perëndia ishte kryesisht aktiv në kohën e Biblës, por pastaj jo më. Dëshmitë mund të na inkurajojnë dhe të na tregojnë se Perëndia po punon ende sot.
 - d. **Leximi i Biblës.** Fjala e Perëndisë është e rëndësishme. Në kishat protestante, foltorja me një Bibël të hapur është qendra e sallës. Edhe në kishat katolike dhe ortodokse ka një foltore, por kurrë në fakt në qendër të sallës së kishës. Në Kisha Katolike ka një tavoline (altar) në qendër, ku kupa dhe pjata me buke janë vendosur. Për Katolikët sakrifica e Jezusit është qendrore. Për ortodoksët, kjo është ikonostas me të gjitha llojet e shenjtorëve në të. Ata besojnë se ata shenjtorë mund të na ndihmojnë. Prandaj, prifti gjatë shërbimit të tij qëndron me shpinën e tij nga besimtarët, me qëllim që të ndërmjetësojë për ta.



- e. **Predikimi**, shpjegimi i Biblës, shih gjithashtu shpjegimin më lart.
- f. **Darka e Zotit**. Festojmë se Jezusi vdiq për ne dhe dha trupin e tij. Ajo është gjithashtu një festim i unitetit të besimtarëve.
- g. **Oferta**. Së bashku kujdesemi për kishën dhe për aktivitetet e ndryshme të kishës. Gjithashtu u japim ndihmë të varfërve.
- h. **Të qëniet së bashku më besimtarët e tjerë**. Të besosh vetëm është e vështirë. Në disa vende nuk lejohet të mblidhesh si besimtarë. Në Shqipëri tani është e lejuar. Askush nuk e di se sa kohë do të zgjasë kjo situatë. Le ta vlerësojmë dhe gjithashtu të lutemi për ata që nuk mundën të mblidhen. Krahaso pjesët e qymyrit që janë të veçuara dhe shuhën. Kur besimtarët janë së bashku, ata mund ta mbajnë zjarrin të ndezur.
- i. **Bekimi në fund të shërbesës**. Në disa kisha, ky është një moment i rëndësishëm. Disa mund të thonë për shembull: “Paqe e Zotit” ose “Zoti shkëlqeftë fytyrën e tij mbi ty” Dikush një herë më tha: ndonjëherë shërbesa më duket e vështirë ose e mërzitshme për t'u ndjekur, por në çdo rast unë marr bekimin e Perëndisë në çdo shërbesë. Kjo në vetvete është e mjaftueshme për mua.

3. Lexojmë “Kisha, të jesh së bashku dhe të shpërndarë”, faqja 2 -3

4. Lexojmë pasazhin e Biblës nga Efesianëve 4:1-6 dhe 11-16

- Pyet paraprakisht se kush e shkroi këtë. Pali.
- Cili ishte profesioni i tij: Bërës tendash.
- Por çfarë studioi? Para teologjisë, ai ishte në fillim hebre dhe vetëm më vonë u bë i krishterë. Ai ka një arsimim të lartë për t'u bërë farise. Shumë inteligjentë. Ja pse ndonjëherë ai shkruan një gjuhë shumë të vështirë, si në fragmentin tonë biblik. Ai shkruan me fjali shumë të gjata.
- Pyet dikë nëse dëshiron të numërojë sa shpesh përdoret fjala "një" në këtë seksion: (7 here) Ka të bëjë me unitetin,



të qenit “një”. Numrat në Bibël shpesh janë simbolikë. Çfarë kuptimi ka numri 7: **Plotësi, Përsosmëri** (krahaso 7 ditë në javë)



5. Pyetje 1 (faqja 4)

- a. Emërtojini të gjitha pjesët e trupit. (Kërkojini dikujt ta bëjë këtë)
- b. Kush është në kishë si:
 1. Kreu (Shpesh thonë se ky është pastori. Jo, Jezusi është kreu i kishës).
 2. Dora: Kush është aktiv dhe bën diçka në kishë (pastrim etj.).
 3. Gojë: Kush flet, lutet, inkurajon, këshillon, etj.
 4. Këmbë: që del jashtë dhe e çon ungjillin në vende të tjera,
 5. Syri: kush sheh çfarë po ndodh, kush ka nevojë për inkurajim, rrezik.
- c. Çfarë roli luan në kishë? Zoti na ka dhënë të gjithë vendin tonë. Të gjithë janë si një pjesë e trupit. Mos mendo se je i parëndësishëm. Pa ty, trupi është i gjymtuar. Mos mendo me krenari se mund t'i bësh të gjitha vetë, pa të tjerët. Atëherë je si një pjesë e trupit që mendon se mund të bëjë pa trup. Por kjo është e pamundur. As ne nuk jemi të gjithë njësoj. Atëherë nuk do të formonim një trup, por një koleksion, për shembull, të të gjitha duarve ose këmbëve. Kjo nuk është trup por një koleksion i ndarë. Prandaj, është e rëndësishme që edhe ne të jemi të ndryshëm. Sigurisht të gjithë të lidhur me kreun = Krishtin.

6. Lexojmë faqe 4 dhe 5 “Letra e Efesianëve”

Flet për pagëzimin. Pali thotë se ne jemi “një” në pagëzim.





7. **Pyetja 2**, faqja 5 (nëse është e mundur në grupe të vogla)
- Sa kohë ka kaluar që kur u pagëzove?
 - Ç'do të thotë të pagëzohesh? (Ti i përket Perëndisë dhe u tregon të tjerëve se je i krishterë) Pyet pse pagëzimi është gjithmonë me ujë. Disa nuk e dinë këtë. Uji është simboli i larjes së papastërtive, mëkateve tona. Zhytja në ujë është gjithashtu një simbol i vdekjes në jetën e vjetër dhe i të ngriturit në jetën e re.
 - Si e përjeton lidhjen me kishën? Pagëzimi nuk është diçka që mund ta bësh vetëm me dy njerëz. Është diçka që e bën si kishë. (në Bibël ka vetëm disa shembuj që njerëzit janë pagëzuar pa kishë, p.sh. Filipi dhe njeriu nga Etiopia. Por ai po shkonte në vendin e tij, ku ende nuk kishte të krishterë)



8. **Diskutojmë pyetjen 3** (faqe 6) në grupe të vogla



- Shpjegoni se figura 1 është vërtet një trup. Por edhe figura 2 është gjithashtu e plotë, por jo e lidhur. Me cilën figurë është kisha jote më e ngjashme? Shpjegoni se ka mjaft kisha që janë si figura b. Ka besimtarë të mirë, njerëz të mirë, por ata vijnë në kishë dhe shkojnë në shtëpi pas shërbimit pa u interesuar për njëri-tjetrin. Nuk është një trup i lidhur.
- Pengesat / Sfidat: Thashetheme, para (bekim ose shkak për konflikt), krenari etj.

9. **Lexojmë faqen 6**



10. **Diskutojmë faqen 7 pyetjen 4**

- A i bën vetë pastori të gjitha?
- Çfarë detyrash mund të bëjnë të tjerët? Si mund të ndihmoni njëri-tjetrin me këtë?
- Anëtarët e tjerë mund të trajnohen hap pas hapi duke u dhënë atyre disa përgjegjësi. Mund të ndihmojë



gjithashtu kur ata mund të trajnohen në ISTL apo kurse të tjera si "Liria në Krishtin".



11. Pyetje 5, faqja 7

Në fakt është një përsëritje, por gjithsesi është mirë ta mendosh përsëri.



12. Ndarja e tregimeve, faqe 8 dhe 9



Shpjegojmë se ka të bëjë me bërjen e pajtimit / faljen pas konflikteve. Ndodhi në Ruandë (ku është ajo? Afrikë). Konflikt i tmerrshëm. Gjenocide. E dy njerëz më në fund e gjetën mënyre për të falur njëri-tjetrin, me ndihmën e Zotit.

Nëse kemi konflikte në kishë, le të mendojmë për këtë histori. Nëse këta dy burra kanë arritur të pajtohen, pse jo dhe ne?



12. Mbyllja me faqen 9 dhe 10 "Në Lëvizje"

Lejojmë njerëzit të zgjedhin një fjalë dhe ta marrin me vete për herë tjetër.:

- Përlulësi
- Butësi
- Durim
- Tolerancë
- Dashuri



13. Mbyllja e takimin me një lutje



Tema e dytë:

Dëshirë dhe pritje




1. **Mirëpresim** njerëzit dhe fillojmë me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.



2. **Fillojmë me fjalën që njerëzit morën herën e fundit**
 - Përlulesi
 - Butësi
 - Durim
 - Tolerancë
 - Dashuri

3. **Hyrja e temës**

Sot do te flasim për dëshirën dhe pritjen. Çfarë pritshmërisë kemi nga Zoti, njëri-tjetri, kisha?



4. **Lexojmë Psalmin 84, faqja 12**



5. **Diskutojmë pyetjet 1 në faqen 12**

Çfarë imazhesh ka në Psalmin 84?

- Shtëpia e Perëndisë
- Zogjtë (shkrimtari është xheloz për ata zogj të vegjël që jetojnë gjithmonë në shtëpinë e Zotit. Ai dëshiron gjithashtu praninë e Zotit)
- Një ditë me Zotin është më e mirë se 1000 ditë në prani të jobesimtarëve.



6. Lexojmë faqen 13 Hyrje



7. Diskutojmë pyetjet 2 (në grupe të vogla)

Kur e përjetuan ata praninë e Perëndisë? Çfarë shembujsh kanë nga kjo? (Le të tregojnë jo vetëm në situata problematike, por ndonjëherë edhe në momente të mira, ose në kohë shumë normale, p.sh. në agimin e një dite të re

8. Lexojmë faqja 14 “I bekuar”



- **Diskutojmë mbi pyetjen 3** në faqen 15
- A vlen vërtet për ne prania e Perëndisë? Apo ndonjëherë jemi të zënë me familjen, punën, hobet etj. A mund ta përshkruajë dikush vlerën e pranisë së Perëndisë? Çfarë fjalësh mendoni?
- Si e përjeton dikush ardhjen për herë të parë në kishë? Të kujtohet kur erdhe për herë të parë në kishë? Në shumicën e rasteve ka të bëjë me vëmendjen, mikpritjen, dashurinë etj. Jo shumë njerëz janë të prekur nga predikimi ose adhurimi në herën e tyre të parë në kishë. Ajo që mbajnë mend është më shumë ngrohtësia që marrin nga njerëzit.



9. Ndarja e tregimeve

Shohim Videon e Kishës në Egjipt. Skanoni kodin

QR ose shkoni te <https://youtu.be/FxAf8dRPwfk>



Diskutojmë për pyetjet 1, 2, 3.

1. Mbledhja e besimtarëve është e rëndësishme për të inkurajuar njëri-tjetrin dhe për të përjetuar praninë e Zotit së bashku.
2. Ndonjëherë njerëzit janë të vakët për të ndjekur shërbesën e kishës. Le të mësojmë nga këta njerëz në Egjipt, se sa sakrifikojnë për të mbajtur shërbesat e kishës. Mund të vijë një moment në Shqipëri/Kosovë kur besimi mund të ndalohe sërish.
3. Është mirë ta kuptosh këtë. Sidomos për njerëzit me prejardhje katolike ose ortodokse. Zoti jo vetëm që jeton



në ndërtesa të bukura, por ai mund të jetë kudo "ku dy ose tre janë mbledhur së bashku në emrin e tij".



10. Në lëvizje:

- a. Perëndia nuk është vetëm në ndërtesa, por edhe në momentet kur jemi së bashku, p.sh. në një kafene, në shtëpi, gjatë një shëtitjeje. E përjetova vetë gjatë një telefonate. ...
- b. Disa njerëz erdhën në kishë, por jo më. Ndoshta nuk kanë më kohë, nuk duan të vijnë, ose nuk mund të vijnë sepse familja nuk lejohet, etj. A e dimë si e përjetojnë tani ata praninë e Perëndisë në jetën e tyre? Mund t'i pyesim për këtë? Mos pyesni: "A mund të vish përsëri në kishë", por: "Si e përjeton tani praninë e Perëndisë në jetën tënde?"



11. Mbyllim takimin me një lutje. Ju mund të luteni vetë ose t'i kërkoni njërit prej pjesëmarrësve të lutet.



Tema e tretë:

Dashuria dhe singëriteti



1. **Mirëpresim** njerëzit dhe fillojmë me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.



2. **Ndarja e tregimeve**

Fillo me pyetjet e takimit të mëparshëm. Perëndia është kudo ku 2 ose 3 njerëz janë së bashku në emër të tij. Mund t'i ndihmojmë njerëzit të vijnë në kishë me makinë. Ose mund të vizitojmë të sëmurët, të bëjmë telefonata, etj.

3. **Tema mësimi 3**

- Pyetje: Nëse do të qëndroja këtu tani me rroba të bardha veshur dhe do të pyesja: "Çfarë profesioni mendoni se kam"?dentist, doktor, infermiere, farmacistë.
- Po të isha veshur me rroba sportive tani, çfarë profesioni do të kisha? Futbollist, atlet....
- Po të isha veshur me uniformë polici, ushtari ?..... Nga rrobat shumë shpesh mund të kuptosh se çfarë profesioni kanë njerëzit.
- Por, si mund ta shohin njerëzit e tjerë prej nesh se jemi të krishterë? Jo për karakteristikat e jashtme, veshjen, por sjelljen tonë, qëndrimin tonë. Po, si vëmendje, mëshirë, durim. Më e rëndësishmja është veçanërisht "dashuria".

4. **Ne lexojmë:** Hyrje, faqen 19.



5. **Ne lexojmë Romakëve 12:9-18.**

(Lexo shumë ngadalë dhe pyet nëse njerëzit duan të zgjedhin 1 varg që u pëlqen më shumë.



6. **Ne diskutojmë pyetjen 1.**

Cili varg është më i rëndësishëm për ty? Cili varg është më i rëndësishëm për kishën tuaj?



7. Lexojmë faqen 20 “Të jesh real”

Paragrafi i parë: Çfarë do të thotë fjala hipokritë? Njerëz që pretendojnë të jenë më të mirë se ata në të vërtetë janë.

A njohim njerëz që bëjnë gjithçka për tu dukur? Le të jemi të kujdesshëm me emrat. Në fakt, është e trishtueshme që këta njerëz janë të tillë, sepse shpesh janë shumë të pasigurt brenda vetes. Por është gjithashtu e bezdisshme, sepse pa sinqeritetin nuk ndihesh mirë me të tjerët.



8. **Vazhdojmë me paragrafin e dytë:** Dashuria nuk do të thotë se jemi gjithmonë dakord me çdo njeri. Krahaso me një fëmijë që dëshiron të prekë sobën. Ti nuk e lejon këtë dhe jep ndëshkim. Pse? Sepse ti nuk do që fëmija të digjet vetë. Kjo tregon dashurinë.

9. Lexojmë faqen 21 “Duajeni njëri-tjetrin”



10. **Diskutojmë mbi pyetjen 2.** Në grupe të vogla

- A është kisha juaj një kishë ku ndiheni të dashur? Si e vëreni këtë?
- Çfarë shembujsh keni për këtë? Kujdesej për të sëmurët, lutjet, inkurajimin? Etj.
- Dashuria gjithashtu kërkon sakrificë. Çfarë sakrificash mund të bësh? Koha, paratë, vëmendja...



11. Lexojmë faqen 22 “Përlësia”

Shpesh përlësia shihet si një dobësi. Nuk duhet të lejojmë që të abuzohemi, por është mirë të duam të jemi më të vegjëlit dhe t'u shërbejmë të tjerëve.



12. Diskutojmë pyetjen 3 (nëse ka kohë të mjaftueshme, kjo mund të bëhet në grupe të vogla).

Përgjigja b: Moisiu ishte një njeri me temperament të shpejtë. Ai vrau një izraelit, goditi shkëmbin (ndërsa Zoti i tha të fliste me gurin) etj. Por në fund të jetës së tij është shkruar se nuk kishte asnjë person tjetër në këtë botë që të ishte kaq zemërbutë si Moisiu, Numrat 12:3.

13. Lexojmë faqe 22 “Lidhshmëria”

Ne mund të jemi vërtet të lidhur me njëri-tjetrin vetëm nëse e kuptojmë dhe përpiqemi ta vendosim njëri-tjetrin në situatën e njëri-tjetrit. Shumë shpesh mendojmë në një përshtypje të parë se e njohim mirë njëri-tjetrin, por kjo shpesh del se nuk është e vërtetë. A e dimë me të vërtetë nëse personi tjetër po ecën mirë apo nëse ai/ajo po merret me papunësinë, fëmijën e sëmurë, dhunën në shtëpi, nëse është i lumtur, i vetmuar etj.

14. Shohim videon e besimtarëve që mendonin se e njihnin njëri-tjetrin. Një lypës ulet në derën e kishës në momentin që fillon shërbesa e kishës. Disa ndihmojnë, disa neglizhojmë.... Në fund duket se pastori i kishës ishte veshur si lypës. Askush nuk e kishte njohur. Besimtarët kishin lloj-lloj mendimesh për të. Disa e shpërfillën, të tjerë e ndihmuan. Por askush nuk e kuptoi se në fakt ishte pastori i tyre. Sa mirë e njohim ne njëri-tjetrin? Dhe sa mirë e njohim situatën e njëri-tjetrit? Skanoni kodin QR ose shkoni te https://youtu.be/1YDM_nNmQ0U



15. Lexojmë faqen 23 Dashuria e paqtë



16. Diskutojmë pyetjen 4



17. Në lëvizje

Në fund të takimit u themi që çdonjëri merr me vete 1 varg (të printuar) dhe mendon për atë varg në javën e ardhshme.



18. Lutja. Ju mund të luteni vetë ose t'i kërkonit njërit prej pjesëmarrësve të lutet.



Tema e katërt:

Mikpritje dhe një qëndrim i hapur



1. **Mirëpresim** njerëzit dhe fillojmë me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.



2. **Ndarja e tregimeve.**
Fillojmë të pyesim për vargun biblik që morën njerëzit me vete herën e fundit. A menduan ata për këtë varg?



3. **Lexojmë Luka 14:1-14**
Pastaj shohim videon për këtë pasazhe biblik. Skanoni kodin QR ose shkoni te <https://youtu.be/owSLIKNVkOE>



4. **Ne diskutojmë pyetjen 1**
 - a. Në cilin varg shohim mikpritje? Vargu 13. Ftoni të dobëtit, lypësit, etj.
 - b. Në cilin varg shohim të kundërtën e mikpritjes? Vargjet 1-4, ku farisenjtë në të vërtetë nuk donin që një hidropik të shërohej, sepse ishte shabat. (Shpjego pse shabati u themelua pas skllavërisë në Egjipt. Njerëzit ishin të lirë në shkretëtirë, por nuk dinin si ta përballonin këtë liri. Pra Zoti dha dhjetë Urdhërimet. Urdhërimi i katërt thotë: Mos puno gjithmonë, si në kohën e skllavërisë. Merr një ditë pushim për Perëndinë, për të afërmit e tu dhe për veten tënde. Më vonë judenjtë i kishin dhënë një interpretim shumë strikt kësaj. Zoti nuk krijoi asgjë në ditën e 7-të, kështu që ne nuk mund të bëjmë asgjë të re, të gatujmë ushqim, të mos nderim sobë, etj. Por kjo nuk është mënyra se si Zoti ka menduar që të jetë. Duhet të jetë një ditë lirie. Pse dita e pushimit është transferuar nga dita e shtatë në ditën e parë? Sepse Jezusi u ngrit nga të vdekurit ditën e parë. Pra, kjo është një ditë e rëndësishme për t'u festuar (Vetëm Kisha Adventiste ende festojnë ditën e 7-të). Në vend që të punojmë për 6 ditë dhe pastaj të pushojmë për 1 ditë, pas



ringjalljes së Jezusit, fillimisht mund të festojmë 1 ditë dhe pastaj mund të punojmë për 6 ditë)

5. Lexojmë faqen 27 “Këshilla për mysafirët” dhe faqen 28



6. Ne diskutojmë pyetjen 2 në grupe të vogla

- Le të tregojnë për njerëzit që njohin. Për shembull njerëzit që janë gjithmonë shumë të zënë me Facebook ose Instagram, sepse duan të kenë shumë pëlqime. Ose njerëz që mendojnë se është shumë e rëndësishme se çfarë mendojnë fqinjët ose anëtarët e familjes për ta.
- Mund të jetë gjithashtu e njëjtë me pastorët ose kishat. Ata bëjnë shumë gjëra vetëm sepse duan të kenë një mendim të mirë nga besimtarët ose kishat e tjera. Ata duan të jenë më të mëdhenjtë, më të famshmit, duan të marrin më shumë vota etj.
- Ne mund t'u themi atyre njerëzve (nëse duan të dëgjojnë) se nuk është e rëndësishme se çfarë mendojnë të tjerët për ne. Më e rëndësishmja është se çfarë mendon Zoti për ne. Identiteti ynë është tek ai, i cili na shpëtoi dhe na fali mëkatet. Kjo është shumë më e rëndësishme se çfarë thonë të tjerët për ne. Në fakt njerëzit që janë shumë të fokusuar për t'u pëlqyer nga të tjerët, shpesh janë njerëz shumë të pasigurt brenda (ata pretendojnë nga jashtë shpesh se janë shumë të sigurt ose ndonjëherë edhe arrogantë. Por brenda janë shpesh të pasigurt dhe kanë nevojë për duartrokitje nga të tjerët).

7. Lexojmë faqen 28 dhe 29 “Këshilla ...”





8. Ne diskutojmë pyetjen 3

9. Ne lexojmë faqen 30 “Mikpritje si nje akt”



10. Ne diskutojmë pyetjen 4

Ndonjëherë kemi mundësi t'i ndihmojmë të tjerët pa folur gjithmonë drejtpërdrejt për Jezusin. Ndonjëherë njerëzit nuk janë menjëherë të hapur për të dëgjuar për Jezusin. Gjithashtu, në veprat tona të mikpritjes p.sh. tregojmë për dashurinë e Perëndisë dhe se njerëzit janë të vlefshëm për Perëndinë. Nëse kemi mundësi të tregojmë për Jezusin, patjetër që kjo është një gjë e mirë për t'u bërë. Ndonjëherë njerëzit na pyesin vetë: Pse po e bën këtë apo atë?



11. Në lëvizje

Lexo faqe 30 dhe 31

Pyetja

- A i ftojme ndonjëherë të tjerët të hanë ose të pinë diçka me ne në shtëpi ose në një kafene? Kjo mund të jetë shumë e vlefshme për njerëzit. Disa janë shumë të vetmuar.
- A njihni njerëz në zonën tënde që janë shumë të vetmuar?
- A mund të lutesh për ta ose t'i ftosh një herë për kafe?





12. Ndarja e tregimeve

Lexojmë tekstin dhe pastaj shohim videon rreth vakteve për refugjatët. Skanoni kodin QR ose shkoni te

<https://youtu.be/Z8ebQRvcaSo>

Pastaj flasim pak për pyetjet a dhe b.



13. Mbyllim takimin me një lutje.

Ju mund të luteni vetë ose t'i kërkonti njërit prej pjesëmarrësve të lutet.



Tema e pestë:

Ndani dhe shërbeni së bashku



1. **Mirëpresim** njerëzit dhe fillojmë me një lutje ose një këngë. Mënyra se si funksionon kjo ndryshon sipas kishës.

2. **Ne lexojmë: faqe 33 “Hyrje”**



3. **Ne lexojmë Mateu 25:31-46**



4. **Ne diskutojmë pyetjen 1, faqe 35**

a. Të japësh ushqim, ujë, vizitosh të sëmurët, etj.

b. Në ditët e sotme është e rëndësishme që t'i ndihmojmë njerëzit me nevojën që kanë në jetën e përditshme, si p.sh. të bëjnë pazar, të lexojnë Biblën (kur njerëzit janë të vjetër ose të verbër), etj.

Është e habitshme që njerëzit vetë nuk e kujtojnë as kur bëjnë ose nuk bëjnë diçka. U habitën që Jezusi e tha këtë. Çfarë thotë kjo? Nuk ka të bëjë me aktivitetet e organizuara, por me atë që bën automatikisht nga zemra. Pra, ka të bëjë me një mentalitet, një qëndrim.

5. **Ne lexojmë faqen 34 “Gjykim”**

Njerëzit janë të ndarë në dy grupe, majtas dhe djathtas. Në Bibël, ana e majtë do të thotë se nuk je i mirë. Kjo ishte e vërtetë në kohën dhe kulturën e Izraelit. Por kjo është ende në shumë kultura sot. Gjithashtu në Afrikë, për shembull, nuk duhet të përshëndesni ose thërrisni kurrë dikë me të majtën. Kjo është fyese, sepse e majta është dora që përdorni në tualet.



6. Ne lexojmë faqen 35 “Shumë serioze”



7. Ndarja e tregimeve

Ne shohim videon e veprave të mira, pasi ato janë të shfaqura në traditën e Kishave Katolike Romake (muzikë me këngë anglisht) Skanoni kodin QR ose shkoni te <https://youtu.be/-FCvpNNL6mA>



Pyetjet:

- a. Varrosja e të vdekurve. Kisha Katolike Romake e shtoi këtë vepër, sepse përveç 66 librave të Biblës, ata kanë edhe librat apokrifë. Një prej tyre është Tobithi, i cili shkruan për varrosjen e të vdekurve, si një vepër e mirë. Në kohët e epidemisë së rëndë, vetëm të krishterët u kujdesën për të varrosur të vdekurit. Kjo ishte e dukshme, madje edhe mes jobesimtarëve. Ajo bëri përshtypje, gjithashtu, edhe mbi sundimtarët e shekullit të 3- të. Prandaj, si një falënderim, ata e shfuqizuan persekutimin e krishterë. Më vonë, Kostandini madje shpalli krishtërimin si fe shtetërore. Pra, kishte të bënte me faktin se jo të krishterët e kuptuan se të krishterët me të vërtetë e modelonin besimin e tyre në veprime.
- b. Vizitohet të sëmurët, ndihmojmë njerëzit që janë të zhveshur etj.....
- c. A ka njerëz nga kisha që vizitojnë të burgosurit? Nëse dëshironi, ekziston një organizatë ku mund të bëheni vullnetar. SHKBSH, shih <https://www.prisonfellowshipalbania.com/sq/homepagin-a-albanees/>
- d. A jemi tani të shpëtuar me anë të besimit apo me vepra? Mund të shtosh: *Jezusi në pasazhin e biblës të Mateut 25 asnjë herë nuk tha: “Je i mirëpritur në parajsë, sepse ke shkuar në kishë, ke besim, je lutur, ke lexuar Biblën etj.” Ai thotë vetëm se janë të mirëpritur sepse kanë bërë gjëra të mira.*



Përgjigje: Nga besimi jemi shpëtuar. Vetëm prej hirit, thotë Bibla tek Efesianëve 2:8,9. Por nuk do të thotë se bëhet pa vepra të mira. Jakobi thotë se besimi është i vdekur pa vepra. Jakobi 2:14-24. Reformatori i njohur Martin Luther ishte fillimisht një prift katolik romak. Por ai luftoi me theksin e asaj kishe mbi veprat e mira dhe indulgjencat. Ai studioi librin e Romakëve dhe mësoi se ne mund të shpëtohem vetëm me anë të besimit dhe hirit. Prandaj Martin Luteri kishte vështirësi me librin biblik të Jakobit. Ai do të kishte preferuar të mos e kishte atë libër në Bibël. Por mua më vjen mirë që e kemi ende Jakobin në Biblën tonë. Ne jemi të shpëtuar me anë të besimit, por pa vepra besimi ynë është i vdekur. Pra të dyja janë të rëndësishme.

8. Ne lexojmë faqen 36 “Të bekuarit”



9. Ne diskutojmë për pyetjen 2 (në grupe të vogla)

- Veprimet janë të rëndësishme. Jo vetëm për të shpëtuar, por edhe për të përcaktuar gjendjen ku përfundojmë pas jetës sonë. Jo të gjithë ne do të arrijmë në të njëjtin vend, disa do të kenë një rang më të lartë se të tjerët.
- Duke folur me njëri-tjetrin për të, duke inkurajuar njëri-tjetrin, duke kërkuar informacion për një aktivitet ose duke ndërmarrë një aktivitet së bashku.

10. Ne lexojmë faqen 36 “Drejtësia”



11. Ne diskutojmë për pyetjen 3

- më të vegjëlit janë ata që nuk shihen si të vlefshëm nga të tjerët.
- Vëllezër: këta mund të jenë edhe jo të krishterë



12. Ne lexojmë faqen 37 “Nuk ka justifikime”



13. Ne diskutojmë për pyetjen 4, faqe 38

- Kjo mund të përfshijë: Pako ushqimore, veshje, vizita te të sëmurët, vëmendje ndaj të paaftëve ose të moshuarve, vakte etj.
- Për shembull për njerëz që janë të varur prej drogës ose alkoolit, njerëzit e vetmuar.
- Mendoni për SHKBSH, Teen Challenge, ABC Clinic, Foodbank,



14. Ndarja e tregimeve

Ne lexojmë historinë e Ana Marisë nga Kolumbia dhe shohim videon. Skanoni kodin QR ose shkoni te

<https://youtu.be/XNIP2VHyPvY>

Bisedojmë për pyetjet.



15. Shërbeni dhe ndani



16. Mbyllim takimin me një lutje.

Ju mund të luteni vetë ose t'i kërkonit njërit prej pjesëmarrësve të lutet.





FOKUSI
Albania - Kosova



www.fokusi.al



Fokusi



info@fokusi.al



0697013501